



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

NR. 5, DATË 15.03.2019.

“Mbi korigjimin e Vendimit Nr. 100, Datë 14.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Alfred Gjoni”

Firdes Shuli	Anëtare
Etleda Çiftja	Kryesuese
Roland Ilia	Relator

Bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Trupi gjykues u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes z. Roland Ilia, për korigjimin e gabimit material në Vendimin Nr. 100, Datë 14.01.2019, të subjektit të rivlerësimit Alfred Gjoni:

Në vendimin Nr. 100, Datë 14.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në dispozitivin e vendimit konkretisht; pika 1 e tij, është bërë një gabim material në gjeneralitetet e subjektit të rivlerësimit është shkruar “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Zefi, gjyqtar pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër.”, ndërkohë duhet të jetë “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, gjyqtar pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Trupi pasi konstatoi se kërkesa e relatorit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi material,

V E N D O S I:

1. Ndrejten e gabimit material në gjeneralitetet e subjektit të rivlerësimit është shkruar “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Zefi, gjyqtar pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër.”, ndërkohë duhet të jetë “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, gjyqtar pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kurbin”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.
3. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes Shuli

Etleda Çiftja

Roland Ilia

Anëtare

Kryesuese

Relator

Sekretare gjyqesore
Olsida Goxhaj